

BACHELOR NË “INFORMATIKË EKONOMIKE”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” synon ta pajisë studentin me njohuri rreth sistemeve të ndryshme të informacionit që mbështesin proceset e sipërmarrjes, biznesit, ekonomisë si dhe të menaxhimit e drejtimit të tyre, duke gjetur metodat më efikase për të përdorur teknologjinë në shërbim të efektivitetit të prodhimit dhe përdorimit të burimeve, njerëzore, financiare dhe infrastrukturore. Qëllimi i programit është të përgatisë specialistë të informatikës, të cilët janë të aftë të implementojnë sistemet teknologjike në zgjidhjen e problemeve ekonomike. Specialistët e kësaj fushe zgjedhin dhe integrojnë produkte hardware dhe software në infrastrukturën e organizatave/institucioneve. Gjithashtu ata janë të aftë të dizenojnë, zhvillojnë e aplikojnë sisteme financiare. Ata instalojnë, përshtatin dhe mirëmbajnë këto aplikacione, duke siguruar një mjedis të sigurt dhe efektiv që mbështet veprimtarinë e përdoruesve të kompjuterit në organizatë.

REZULTATET E TË NXËNIT

Studenti pas përfundimit të programit do të jenë në gjendje të:

- demonstrojë ekspertizë në fushat e Algoritmeve, Programimit, Arkitekturës Kompjuterike, Bazave të të Dhënave, Big Data dhe Business Intelligence etj.
- identifikojë dhe vlerësojnë faktorët që diktojnë drejtimin, administrimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve në ekonominë e tregut të lirë, parë nga pikëpamja e teknologjisë së informacionit;
- demonstrojë ekspertizë në aspektet teorike, dhe veçanërisht në aftësitë praktike të zbatueshme në fushat e shërbimeve elektronike, organizimit të sistemeve kompjuterike, web design, inxhinierisë softuerike etj.
- Identifikojë dhe vlerësojë në mënyrë kritike problemet specifike të informatikës ekonomike, si dhe përdorimin efektiv të teknologjisë për zgjidhjen e problemeve ekonomike, planifikimit dhe administrimit.
- aplikojë dhe të përdorë analizat kompjuterike për funksionimin e ndërmarrjes, varësinë reciproke dhe ndikimin nga faktorët politikë, ekonomikë dhe socialë;
- interpretojë planifikimin strategjik të zhvillimit të organizatës në afat të gjatë dhe të shkurtër, duke përdorur mjete teknologjike dhe software;
- hartojë dhe interpretojë politikat teknologjike që nxisin aktivitetin ekonomik, zgjerimin e biznesit dhe investimet në fusha të reja.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

1. Specialist IT, Dizenjues i rrjetave kompjuterike
2. Specialist IT, Programues
3. Specialist për proceset e biznesit
4. Specialist IT në sektorin bankar
5. Specialist IT në sektorin e sigurimeve
6. Specialist IT në institucione financiare
7. Specialist i burimeve njerëzore
8. Specialist marketingu në mjedisin digjital
9. Specialist për statistikën bankare
10. Specialist i teknologjisë së informacionit, etj.



BACHELOR "INFORMATIKË EKONOMIKE" 180 ECTS

Nr.	Viti	Sem.	Emri i lëndës	ECTS
-----	------	------	---------------	------

A - LËNDË BAZË/ 15-20%/36 ECTS

1	I	1	Matematikë 1	6
2	I	2	Matematikë 2	6
3	I	2	Hyrje në sociologji	6
4	I	2	Shkrim akademik dhe Metoda kërkimi	8
5	II	1	Teori e statistikës	6
6	II	2	Statistikë e Aplikuar	4
				36

B - LËNDË KARAKTERIZUESE TE PROGRAMIT 50-55%/94 ECTS

1	I	1	Hyrje në ekonomi	6
2	I	1	Parimet e kontabilitetit	8
3	I	2	Hyrje në Financë	6
4	I	1	Arkitektura dhe organizimi i kompjuterit	6
5	II	1	Algoritmikë dhe Hyrje në Programim	6
6	II	1	Hyrje në menaxhim	8
7	II	2	Rrjeta kompjuterike	6
8	II	2	Programim 1	6
9	II	2	Sistemet e operimit	6
10	II	1	Teori e bazave të të Dhënave	6
11	III	1	Programim 2	6
12	III	1	Bazat e marketingut	6
13	III	1	Hyrje në Big Data dhe Inteligjencën e Biznesit	6
14	III	2	Web Development	6
15	III	2	Hyrje në Inxhinieri Softwerike	6
				94

C - LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE /12-15%/24 ECTS

1	II	2	Kontabilitet financiar	6
2	II	2	Sisteme informacioni në menaxhim	6
3	III	1	E-Shërbimet	6
4	III	2	Parimet e kërkimit të tregut	6
5	III	1	Hyrje në menaxhimin e operacioneve	6
6	III	1	Zhvillimet e aplikacioneve mobile	6
7	III	2	Hyrje në menaxhim risku	6
8	III	1	Sistemet e informacionit dhe Siguria	6
9	III	2	Honors Course	6
				24

D - LËNDË PLOTËSUESE 10-15%/20 ECTS

1	I	1	Bazat e Informatikës	4
2	I	2	Anglisht	5
3	II	1	Hartim dhe menaxhim projektsh	6
4	III	2	Praktikë dhe zhvillim karriere	5
				20

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/3-5% /7 ECTS

1	III	2	Punimi i diplomës/Provimi i përgjithshëm përfundimtar	7
---	-----	---	---	---